



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

Datë:	18.02.2022
Për:	Z. Daut AZEMI – Kryesues i Kuvendit të Komunës
Përmes:	Z. Imri AHMETI – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Nga:	Imri SEMETISHTI – Drejtor i Departamentit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit
Lënda:	Propozim për marrjen e Vendimit për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës



I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës,

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, ju dorëzojmë Propozim Vendimin për shqyrtim dhe miratim për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2023 -2031.

Në bashkëlidhje të këtij akti ju dorëzojmë:

1. Propozim Vendimin për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Lipjanit;
2. Programin e Punës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Lipjanit; dhe
3. Vendimin për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit Zhvillimor Komunal të vitit 2013.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
SKUPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunes propozon që:

Në bazë të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 17 paragrafi 1, shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 5 paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1, nenit 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, nenit 10 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe duke u mbështetur në nenin 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110/78095 të datës 24.12.2021 Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022, miratoi këtë:

PROPOZIM

V E N D I M

PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË LIPJANIT

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë Vendim aprovohet fillimi i procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) për Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Përkufizimi i Planit Zhvillimor Komunal

Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial, me të cilin përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor në nivelin lokal.

Neni 3

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal

Komuna e Lipjanit ka në zbatimin PZHK të miratuar në vitin 2013 i cili skadon në vitin 2023. Në bazë të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna duhet të hartoj Planin Zhvillimor Komunal për periudhen vijuese së paku prej tetë (8) vitesh.

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe në bazë të dokumenteve planore të nivelit nacional.

Neni 4

Parimet e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe përmbajtja

1. Plani Zhvillimor Komunal do të bazohet në parimet e përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, duke përfshirë promovimin e interesave të qytetarëve, transparencën dhe pjesëmarrjen publike.
2. Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit. Në mënyrë që të përcaktohen prioritetet e qëndrueshme strategjike, me Planin Zhvillimor Komunal shqyrtohen, vlerësohen dhe merren parasysh të gjitha kërkesat e përcaktuara me nenin 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.
3. Plani Zhvillimor Komunal përbëhet nga pjesët tekstuale dhe hartografike të cilat prezantohen në mënyrë digjitale dhe në format të shtypur për miratim dhe nënshkrim formal.

Neni 5

Përgjegjësitë e Kuvendit Komunal lidhur me Planin Zhvillimor Komunal

1. Në bazë të nenit 10 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Kuvendi Komunal është përgjegjës për:
 - 1.1. Aprovimin e propozim Vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal; dhe
 - 1.2. Aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Neni 6

Bartësi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal

Në bazë të nenit 54 të Statutit të Komunës, bartës i procesit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal është Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 7

Konsultimet dhe shqyrtimet publike

1. Projekt Plani Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime dhe shqyrtime publike në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.
2. Paraqitja e Projekt Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e vlerësimeve publike lidhur me ndikimet e mundshme sociale, ekonomike dhe mjedisore, do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 8
Afati i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij Vendimi është i obliguar që dokumentin – Planin Zhvillimor Komunal ta hartojë në afat të arsyeshëm kohor, duke respektuar të gjitha fazat e përcaktuara për hartim sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9
Gjuha zyrtare

Plani Zhvillimor Komunal hartohet në gjuhët zyrtare të përcaktuara me Ligjin në fuqi për gjuhët zyrtare si dhe në gjuhën angleze.

Neni 10
Afati i Vlefshmërisë

Plani Zhvillimor Komunal hartohet dhe zbatohet për periudhën tetë (8) vjeçare 2023-2031. Ky afat fillon të llogaritet nga dita e hyrjes në fuqi të Planit.

Neni 11
Programi

Pjesë e këtij Vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit hapësinor sipas nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtojcë:
Programi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

1Nr. 1-011-9359
Lipjan, Më 18.02 2022



SHTOJCË 1.

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, propozim Vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Lipjanit, I bashkëngjitet:

PROGRAMI PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË LIPJANIT

I. Në Programin për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal përfshihen:

1. Kërkesat e nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor; dhe
2. Veprimet administrative dhe aktivitetet profesionale lidhur me përgatitjen dhe hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

1. Kërkesat e nenit 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

1.1. Lloji dhe përkufizimi i Planit Zhvillimor Komunal

Plani Zhvillimor Komunal¹ është akti më i lartë i planifikimit hapësinor në nivel lokal. Në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal duhet të jetë Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial, me të cilin përcaktohen caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Në Planin Zhvillimor Komunal duhet të përfshihet plani për zhvillimin e të gjitha zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

1.2. Qëllimi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal

Me Planin Zhvillimor Komunal planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimit të tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit në territorin e Komunës së Lipjanit me qëllim të marrjes së vendimeve adekuate për përdorimin e ardhshëm të hapësirës, përcaktimin e regjimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të tij, si dhe aktivitetëve socio-ekonomike dhe mjedisore në territorin e Komunës së Lipjanit.

1.3. Përfshirja e territorit në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal

Sipas të dhënave nga Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Komuna e Lipjanit ka sipërfaqe prej 338,64km² të ndarë në 58 Zona kadastrale. E gjithë kjo sipërfaqe (zona urbane dhe rurale) do të përfshihet në kuadër të planifikimit hapësinor me Planin Zhvillimor Komunal.

¹ Neni 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

1.4. Subjekti përgjegjës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Bartës i procesit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal është Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Kjo përgjegjësi është përcaktuar edhe me nenin 54 të Statutit të Komunës.

Meqenëse Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial, atëherë Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, do të përkrahet edhe nga drejtoritë sektoriale.

1.5. Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Në përputhje me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, mjetet financiare për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Lipjanit.

Drejtoriati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës, si dhe me subjektet e jashtme në cilësinë e ekspertëve të fushave të caktuara dhe në cilësinë e palëve me interes.

2. Veprimet administrative dhe aktivitetet profesionale lidhur me përgatitjen dhe hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Në kuadër të kësaj komponente përfshihen veprimet përgatitore bazuar në aktet administrative për Planin Zhvillimor Komunal të vitit 2013 mbi bazën e të cilit do të bëhen vlerësimet si pikënisje për përgatitjen e detyrës projektuese dhe për hartimin e Planin Zhvillimor Komunal. Në kuadër të kësaj përfshihet edhe korniza strategjike planore si: Plani i Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Harta Zonale e Komunës së Lipjanit, Plani Hapësinor i Zonës së Interesit të veçantë "Kleçke dhe Divjakë", projektet e infrastruktures rrugore nga Ministria e Infrastruktures si autostrada „Arbër Xhaferi“, rruga magjistrale Lipjan-Gjilan, Zona e veçantë e mbrojtur në Lipjan, vendbanimi –Janjevë dhe projektet tjera të cilat janë planifikuar në nivel nacional sipas të cilave ndikohet komuna e Lipjanit, si dhe projektet tjera të cilat ndikohen nga ndryshimet përkatësisht harmonizimet e tyre.

Nr.	Detyra/objektivat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
I.	VEPRIMET PËRGATITORE				
1.	Themelimi i Grupit Punues	-Përcaktimi i anëtarëve të Grupit Punues (GP) dhe udhëheqësit të projektit; -Anëtarët e GP caktohen nga DPUMM dhe Drejtoratet sektoriale	Caktimi i përgjegjësisë për bartjen dhe realizimin e projektit - PZHK	Shtatë (7) ditë pas miratimit të Vendimit për hartimin e PZHK-së	Kryetari i Komunës
2.	Përcaktimi i grupeve të interesit	-Përcaktimi i grupeve lokale të interesit, institucione të qeverisë qendrore, organizata të jashtme që ofrojnë shërbime publike, OJQ, biznese, përfaqësues të fshatrave dhe bashkësive lokale.	Të ofrohet kontributi nga grupet e caktuara për hartimin e PZHK-së	1 javë	GP dhe DPUMM

		-Krijimi i listës dhe kontakteve të pjesëmarrësve.			
3.	Njoftimi i punonjësve të Komunës të ndërlidhur me hartimin e PZHK	Njoftimi i drejtorive sektoriale rreth procesit të planifikimit hapësinor me PZHK-në dhe detyrimet që do të parashtrihen në proces	Përfshirja e synimeve themelore sektoriale në kuadër të PZHK-së	2 javë	GP dhe DPUMM
4.	Hartimi i konceptit dhe planit të punës	-Shqyrtimi i Kornizës ligjore të PZHK-së sipas UA përkatës dhe Ligjit; -Identifikimi i Rrezeve/ Kërcënimeve të mundshme; -Vlerësimi i zbatimit të PZHK paraprak; -Vlerësimi i HZK; -Analizimi i PHK që përcakton zhvillimet per Komunen; -Krijimi i strukturës përmbajtësore të PZHK-së; -Prezantimi i strukturës së dokumentit dhe konceptit të punës para drejtorive Komunale.	Hartimi i konceptit dhe planit të punës si pikënisje për hartimin e PZHK-së	2 javë	GP
5.	Procedura për përzgjedhjen e kompanisë konsulente për hartimin e PZHK	Zhvillimi i procedurave përkatëse të prokurimit për përzgjedhjen e kompanisë konsulente për hartimin e PZHK-së	Përzgjedhja e kompanisë konsulente	Sipas afateve të përcaktuara me Ligjin për Prokur. Publik	Drejtorati për Prokurimin Publik
6.	Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët	-Përgatitja e prezantimit të planit të punës dhe qëllimit të PZHK për takimin njoftues me banorët dhe GP. -Takimi njoftues me banorë të zonës urbane dhe GP.	Njoftimi i banorëve me procesin e planifikimit hapësinor në komunën e Lipjanit dhe me të drejtat e tyre në këtë proces	3 javë	GP dhe kompania konsulente
II. GRUMBULLIMI DHE VLERESIMI I TË DHËNAVE NGA DREJTORITË KOMUNALE					
1.	Grumbullimi i të dhënave relevante për hartimin e PZHK	-Grumbullimi i të dhënave relevante nga Drejtoritë sektoriale në Komunë; -Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga institucionet qendrore dhe ndërmarrjet publike.	Grumbullimi i të dhënave sipas UA për PZHK me qëllim të krijimit të konceptit të planifikimit hapësinor	2 javë	GP dhe kompania konsulente
2.	Analizimi dhe vlerësimi i të dhënave	Analizimi dhe vlerësimi i të dhënave të grumbulluara dhe formatimi i tyre me qëllim të zhfrytëzimit sipas UA përkatës për PZHK.	Shfrytëzimi i të dhënave relevante dhe në pajtueshmëri me UA për	2 javë	GP dhe Kompania konsulente

			PZHK		
3.	Identifikimi i kërkesave shtesë sipas legjislacionit në fuqi.	Analizimi i kërkesave shtesë dhe plotësimi i tyre sipas vlerësimit.	PZHK të përmbajë të gjitha të dhënat sipas kërkesave ligjore.	1 javë	GP
III. PËRGATITJA E PROFILIT TË KOMUNËS					
1.	Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit komunal	Plotesimi i Profilit me të dhënat e grumbulluara, si vjon: - Historiku i zhvillimit të Komunes; - Pozita; - Gjendja ekzistuese demografike; - Gjendja ekzistuese e veçorive mjediorë; - Zhvillimi ekonomik; - Infratsuktura teknike; - Transporti; - Infrastruktura publike; - Infratsuktura sociale; - Mjedisit dhe sipërfaqet me rrezikshmeri; - Trashëgimia kulturore, natyrore dhe turistike; - Vendbanimet; - Shfrytëzimi i tokës.	Pasqyra ekzistuese në fushat e caktuara me qëllim të krijimit të bazës themelore për hartimin e PZHK	3 javë	GP dhe Komania konsulente
2.	Konsultimi i Profilit komunal nga Grupet punuese	- Vlerësimi i profilit; - Vlerësimi i profilit nga GP; - Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve;	Grumbullimi i të dhënave të kërkuara sipas UA për PZHK	1 javë	GP
3.	Shqyrtimi publik i Profilit	- Përgaditja e prezantimit të Profilit për diskutim publik; - Zhvillimi i shqyrtimit Publik të profilit.	Prezantimi Publik i Profilit të Komunës	1 javë	GP
4.	Plotesimi dhe hartimi i Profilit Komunal	- Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve nga banorët. - Hartimi i përmbajtjes tekstuale dhe grafike të Profilit Komunal.	Profili i komunës si proces i veçantë të jetë i përfunduar	1 javë	GP
5.					
IV. PËRGATITJA E VLERËSIMIT TË GJENDJES EKZISTUESE					
1.	Vlerësimi i gjendjes nga të dhënat e Profilit Komunal për fushat kyçe dhe analizimi i tyre	Vlerësimi i gjendjes përfshinë fushat tematike por pa u kufizuar në: - Ekonomike; - Infrastruktural teknike; - Infrastruktural e transportit dhe transportin; - Infrastruktural publike dhe sociale; - Mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri; - Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe	Të krijohen informacione të mjaftueshme dhe të bazuara me qëllim të planifikimit të fushave të caktuara për periudhën vijuese.	3 javë	Grupi Punues

		turistike; -Vendbanimet; -Banimin; -Venbanimet Joformale; - Shfrytëzimin e tokës;			
2.	Konsultimi i vlerësimit të gjendjes ekzistuese nga Grupet punuese	- Shqyrtimi i vlerësimit të gjendjes ekzistuese nga GP - Shqyrtimi i vlerësimit të gjendjes ekzistuese të profilit nga GP - Shqyrtimi i vlerësimit të gjendjes nga Konsuletët. - Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve	Finalizimi i dokumentit për vlerësimin e gjendjes ekzistuese nga grupet punuese.	1 javë	Grupi Punues
V. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR, PËRGATITJA E E SWOT ANALIZËS, VIZIONIT, QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE					
1.	Prezantimi i procesit të përgjithshëm strategjik dhe qasja zhvillimore për të ardhmen. Zhvillimi i punëtorisë për caktimin e SWOT analizës, vizionit, qëllimeve, objektivave dhe prioritetëve strategjike	- Përcaktimi i rendit të ditës dhe pjesëmarrësve në punëtori; - Përcaktimi i SWOT analizës së gjendjes ekzistuese për: zhvillimin ekonomik, infrastrukturën teknike, transportin, infrastrukturën publike dhe sociale, mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, vendbanimet, shfrytëzimin e tokës. - Përcaktimi i Vizionit, dhe qëllimeve; - Përcaktimi i objektivave dhe prioritetëve strategjike për komponentet e përmendura më sipër.	Zhvillimi i punëtorisë dhe nxjerrja e produktëve konkrete lidhur me Kornizën e Zhvillimit Hapësinor	1 javë	GP dhe kompania konsulente
2.	Përgaditja e kornizës së zhvillimit hapësinor	- Përgaditja e Kornizës së zhvillimit hapësinor dhe skenarët e mundshëm; - Shqyrtimi i Kornizës së zhvillimit hapësinor nga GP dhe kompania konsulente, duke përfshirë skenarët e propozuar; -Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve;	Grumbullimi i të dhënave sipas UA për PZHK	3 javë	GP
3.	Shqyrtimi publik i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor.	- Përgaditja e shqyrtimit publik për prezantimin Kornizës së Zhvillimit Hapësinor; - Zhvillim i diskutimit për Kornizën e Zhvillimit Hapësinor;	Prezantimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor - vizionit	1 javë	Grupi Punues
4.	Plotësimi dhe përfundimi i elementeve themelore në	-Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve pas shqyrtimit publik.	Nxjerrja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor si	1 javë	Grupi Punues

	kuadër të Kornizës së Zhvillimit Hapësinor		dokument përfundimtar		
VI.	PRIORITETET E ZHVILLIMIT STRATEGJIK DHE PLANI I VEPRIMIT				
1.	Përcaktimi i prioriteteve zhvillimore strategjike në përputhje me Vizionin, Qëllimet dhe Objektivat dhe duke u bazuar në resurset financiare, njerëzore dhe hapësinore	Përcaktimi i aktiviteteve sipas planeve zhvillimore sektoriale	Përcaktimi i planeve dhe veprimeve konkrete për zbatimin e prioriteteve zhvillimore strategjike	2 javë	GP
2.	Përgaditja e Planit të veprimit ku përfshihen të gjitha hollësitë për projektet dhe veprimet e nevojshme për të arritur objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik.	Përcaktimi i Planit të veprimit dhe masave për zbatim dhe monitorim për arritjen e qëllimeve dhe objektivave sipas fushave sektoriale	Hartimi i Planit të Veprimit sipas nenit 10 të UA për PZHK-në.	2 javë	Grupi Punues
VII.	KONSOLIDIMI DHE PËRFUNDIMI I PËRMBAJTJES SË HZK-ës				
1.	Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së PZHK	-Përfundimi i kapitujve të caktuar; dhe - Konsolidimi i tërë dokumentit.	Zbatimi i të gjitha kërkesave ligjore për përfundimin e PZHK	2 javë	GP dhe kompania konsulente
2.	Dorëzimi i PZHK në MMPH për vlerësimin e përmbajtjes para zhvillimit të shqyrtimit publik.	-Dorëzimi i Draftit përfundimtar në MMPHI; -Përgaditja e prezentimit të Draftit përfundimtar të PZHK në MMPHI; -Miratimi nga MMPHI për iniciimin e shqyrtimit publik të draftit përfundimtar të PZHK në MMPHI	Ecurite ligjore	3 javë	GP dhe kompania konsulente
VIII.	SHQYRTIMI PUBLIK I PZHK				
1.	Vendimi për zhvillimin e Shqyrtimit Publik	-Përgatitja e vendimit për shqyrtimin publik të PZHK-së; - Njoftimi i banorëve dhe palëve me interes për zhvillimin e shqyrtimit publik;	Të merren veprimet procedurale drejt finalizimit të PZHK	30 ditë	GP dhe kompania konsulente
2.	Zhvillimi i Shqyrtimit Publik	- Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi publik i draftit përfundimtar të PZHK; - Mbajtja e ekspozitës të përmbajtjes së draftit përfundimtar të PZHK;	Të merren veprimet procedurale drejt finalizimit të PZHK	1 javë	Kryetari i Komunës, GP dhe kompania konsulente

		- Pranimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorëve dhe subjektet tjera.			
3.	Raporti i Shqyrtimit Publik	- Përgatitja e Raportit të Shqyrtimit Publik	Të hartohet në formë të shkruar Raporti nga shqyrtimi publik	1 javë	GP
4.	Inkoorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve	Plotësimi i PZHK-ës në përputhje me vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e arsyeshme të dorëzuara	Të merren veprimet procedurale drejt finalizimit të PZHK	1 javë	GP
5.	Hartimi i VSM	Zhvillimi i procedurave përkatëse për VSM Shqyrtimi publik për VSM	Të analizohet dhe vlerësohet ndikimi strategjik mjedisor i PZHK	4 javë	GP
IX. MIRATIMI I PZHK					
1.	1. Miratimi i PZHK-ës nga MMPH	- Dorëzimi i PZHK-ës në MMPH për miratim; - Inkoorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga MMPH; - Miratimi i PZHK-ës nga MMPH.	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	2 javë	Grupi Punues
2.	2. Miratimi i PZHK-ës nga Kuvendi Komunal	- Dorëzimi PZHK-ës në Kuvend Komunal për miratim; - Inkoorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga Kuvendi Komunal; - Miratimi i PZHK-ës nga Kuvendi Komunal.	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	2 javë	Kryetari i Komunës dhe DPUMM



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Ne baze te nenit 13 paragrafi 13.9 neni 14 paragrafi 14.6 dhe 14.7 te ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003/14 dhe nenit 10 paragrafi 14.9 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003/14 dhe Nr.03/L-106, nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 9 pika b, neni 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 dt. 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 24. 07. 2013, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miraton kete:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLOTËSIMIT DHE NDRYSHIMIT
TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL
DHE PLANIT ZHVILLIMOR URBAN TË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet plotësimi dhe ndryshimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Lipjanit në tekstin e mëtejshëm: Plani Zhvillimor Komunal i Lipjanit 2013-2023*, dhe Plani Zhvillimor Urban i Lipjanit 2013-2023*.

Neni 2

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi definohet hapësira dhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara sipas Vendimit për hartimin-Plotësimin dhe Ndryshimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Lipjanit 15Nr.350-2433 dt.10.05.2011

Neni 3

Plani nga neni 1 i këtij Vendimi është hartuar nga Instituti „INSI“ Sh.p.k me seli në Prishtinë, i përmbledhur në elaborat i cili përmban pjesë tekstuale dhe grafike, dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

Neni 4

Plani sipas nenit 1 të këtij Vendimi është përmbledhur në elaborat në kopje analoge dhe digjitale i vërtetuar me vulën e Komunës, prej të cilit një kopje ruhet në dokumentacionin e Drejtoratit për Administratë –Sektorit për punë të Kuvendit të Komunës, një kopje në arkivin e organeve të Administratës së Komunës ndërsa kopjet tjera në Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Plani Zhvillimor i Komunës 2004-2015, 1Nr.30-183 dt.25.03.2005, dhe Planet tjera integrale të hartuara deri më tani të cilat janë në nivel të Planit zhvillimor urban.

Neni 6

Për zbatimin e Planit nga neni 1 i këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet ekzekutive të Komunës .

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në faqen elektronike dhe Tabelën e shpaljeve të komunës.

15 Nr. 12514

Lipjan, me 23. 08. 2013

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT



**Kryesuesi
Luizim Rustemi**